



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA IV**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 67

Prishtinë, më 25.1.2013, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE**  
**MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi dhe Ganimete Musliu

**Munguan:** Rasim Demiri dhe Danush Ademi

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Naim Hoxha, këshilltar nga OSCE, Dhurata Kryeziu, OSCE.

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj

**Mbledhjen e kryesoi:** Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur, më 15.1.2013;
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2013;
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

### **1. Miratimi i Rendit të ditës**

**Kryetari i Komisionit-** Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e rendit të ditës, dhe kërkoi nga anëtarët nëse pajtohen me këtë rend dite.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të Komisionit të mbajtur më 15.1.2013**

**Kryetari i Komisionit-** Konstatoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes, të Komisionit, të mbajtur më **15.1.2013**. Procesverbali u miratua pa ndryshime.

### **3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2013**

**Kryetari i Komisionit-** Për planin e punës së Komisionit për vitin 2013, kërkoi nga anëtarët nëse kanë ndonjë vërejtje ose plotësim.

**Rexhep Selimi** - Tha në përgjithësi plani është në rregull, por tani jemi në fund të janarit dhe po i shohë disa çështje, prandaj nuk e di, a i kemi përmbushur për këtë muaj. Do të ishte mirë që bashkërisht të punojmë, në mënyrë që ta përmbushim me kohë këtë plan.

**Kryetari i Komisionit** - Ne do të jemi më të saktë në përmbushjen e planit dhe do të kërkoj edhe nga administrata që të na njoftojnë për muajin vijues për aktivitetet që i kemi, në mënyrë që të jemi korrektë dhe të saktë me këtë plan.

**Vjollca Krasniqi** - Unë po e shoh që në këtë plan pothuajse të gjitha projektligjet i kemi prapë në plotësim ndryshim. Të gjitha këto ligje, janë ligje që ne i kemi miratuar në këtë legjislaturë, prandaj nuk po e kuptoj pse po ndodh kjo.

**Kryetari i Komisionit-** Dua ta bëjë një sqarim. Të gjitha ligjet që lidhen me procesin e liberalizimit të vizave, kanë vërejtje në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, për këtë arsye kanë ardhur prapë në plotësim ndryshim sepse duhet të përputhen me ligjet e BE-së.

**Rexhep Selimi** - Për të gjitha këto ligje shtrohet pyetja se çka do të ndryshojë në aspektin politik. Dihet se ligjet shembull që lidhen me FSK, do të vijnë në plotësim ndryshim, sepse siç dihet së shpejti do ti ndryshohet emri nga FSK në UK. Mirëpo, këto janë ligje që nuk kanë të bëjnë me FSK dhe nuk dihet se çka do të ndryshohet në to.

**Fatmir Xhelili-** Unë mendoj se nuk duhet të shkojmë me supozime këtu, sepse mund të jetë vetëm një nen që duhet të plotësohet dhe pikërisht këtu mund të jenë vërejtjet. Dihet shumë mirë që zyrat ligjore i kemi të dobëta, prandaj edhe mund të ketë lëshime të tilla. Sa i përket volumit të paraparë në këtë plan, besoj që për ne është i realizueshëm dhe mund t'i arrijmë me kohë.

**Kryetari i Komisionit-** Gjithashtu desha t' ju njoftojë, se unë kam pasur një takim me organizatat që na ndihmojnë në punën tonë. Prandaj, agjendat e mundshme me këto organizata mund ti bëjmë kohë pas kohe dhe t'i futim si pjesë të planit të punës tonë.

**Kryetari i Komisionit-** Pas vlerësimit nga anëtarët për planin e punës së Komisionit, hapi votimin për miratimin e tij.

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, njëzëri , nxori këtë*

### **PËRFUNDIM**

*Miratohet Plani i punës së Komisionit Për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për vitin 2013.*

#### **4. Të ndryshme.**

Në këtë pik u diskutua dhe u vendos që punëtoria e mbështetur nga OSBE, për përmbylljen e planit të punës për vitin 2013, të mbahet me 29.1.2013, në Pejë.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroj mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Ahmet Isufi**